

DEKRET
Nr.7394, datë 12.6.1990

**PËR DASA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.4494, DATË 31.3.1969 “PËR SHPRONËSIMIN
DHE MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË PASURISË”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

**PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Neni 2 i dekretit të mësipërm ndryshohet si vijon: “Shpronësimi i pasurisë bëhet me vendim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit dhe për Tiranën me vendim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rajonit”.

Neni 2

Në nenin 3, paragrafi i parë ndryshohet si vijon: "Shpërblimi i shpronësimit caktohet nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe të rajoneve për Tiranën në masën e vlefës reale të pasurisë në kohën e shpronësimit. Shpërblimi jepet në të holla ose në një pasuri tjetër”.

Neni 3

Shpërblimi i shpronësimit në masën e vlefës reale, të jepet edhe për ato pasuri, të cilat megjithëse janë shpronësuar nuk janë shembur apo nuk janë vënë në përdorim të shtetit, të kooperativave bujqësore ose të organizatave shoqërore deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij dekreti.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË**

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI RAMIZ ALIA
